

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/16 dhe 83/18), duke vepruar sipas një njoftimi për përqendrim të parashtruar nga shoqëritë Lamium Trejd Limited, me seli në Griva Digeni 115, Qendra Trident, 3101, Limasol, Republika e Qipros, X-Planet, zhvillim dhe inxhinieri projektsh, d.o.o., me seli në 55A rruga Verovshkova, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë dhe IVIKOM Holding GmbH, me seli në Viedner Hauptshtrese 76/2/1, A-1040 Vjenë, Republika e Austrisë, përmes Bozhidar Millosheviqit, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 10.05.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Lamium Trejd Limited, me seli në Griva Digeni 115, Qendra Trident, 3101, Limasol, Republika e Qipros, X-Planet, zhvillim dhe inxhinieri projektsh, d.o.o., me seli në 55A rruga Verovshkova, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë dhe IVIKOM Holding GmbH, me seli në Viedner Hauptshtrese 76/2/1, A-1040 Vjenë, Republika e Austrisë, mbi shoqërinë VE Rakova Bara d.o.o. ZHagubica, me seli në Jug Bogdan 2, Zhagubica, Serbi, përmes blerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 03.04.2023, ndërsa e plotësuar më 13.04.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga shoqëritë Lamium Trejd Limited, me seli në Griva Digeni 115, Qendra Trident, 3101, Limasol, Republika e Qipros, X-Planet, zhvillim dhe inxhinieri projektsh, d.o.o., me seli në 55A rruga Verovshkova, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë

dhe IVIKOM Holding GmbH, me seli në Viedner Hauptshttrase 76/2/1, A-1040 Vjenë, Republika e Austrisë, ku shoqëritë Lamium Trejd Limited, Qipro, X-planet, zhvillim dhe inxhinieri projektsh, d.o.o., Slloveni dhe IVIKOM Holding GmbH do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi VE Rakova Bara d.o.o. Zhagubica, me seli të regjistruar në adresën Jug Bogdan 2, Zhagubicë, Serbi, nëpërmjet blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Shoqëria Lamium Trejd është një shoqëri në kuadër të Grupit MK, e cila është nën kontrollin përfundimtar të z. Miodrag Kostiq ("Grupi MK "). Grupi MK përfshin më shumë se 40 kompani të lidhura që punojnë në Serbi dhe jashtë saj, dhe që punësojnë më shumë se 6,000 njerëz.

Aktiviteti afarist i Grupit MK në tërësi është në thelb prodhimi dhe tregtia e produkteve bujqësore. Grupi MK është aktive në prodhimin e panxharit të sheqerit, sheqerit, misrit, grurit, elbit, panxharit yndyror dhe kulturave të tjera të fushës duke përdorur masat më moderne agroteknike dhe makineritë bujqësore të gjeneratës së fundit. Përveç kësaj, Grupi MK tregon produkte bujqësore, plehra artificiale, pesticide, produkte komerciale dhe produktet e farës (gruri, misër, soje...). Për më tepër, Grupi MK merret me turizmin, teknologjitë e informacionit, si dhe me punën bankare dhe ndërmjetësuese.

Grupi MK nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Grupi MK gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut përmes shitjes (eksportit) të produkteve bujqësore (grurë, ushqim të ngrirë, ushqim të përhershëm të konservuar, ushqime të gatshme, mish të freskët).

Shoqëria X-Planet, zhvillim dhe inxhinieri projektsh, d.o.o. është një shoqëri sllovene e themeluar në vitin 2020 nga shoqëritë Purpura d.o.o. (Purpura d.o.o.) dhe Roblek d.o.o. (Roblek d.o.o.), shoqëri sllovene në pronësi të z. Matjazh Filipiq (50%) dhe z. Bojan Kunovar (50%). Shoqëritë e portofolit në të cilat z. Filipiq dhe z. Kunovar janë pronarët e vetëm ose të vërtetë (direkt ose indirekt) të listuar si „Grupi Alfa”. Aktiviteti kryesor i regjistruar i X-Planet X-Planet, zhvillim dhe inxhinieri projektsh, d.o.o. është aktivitetet e biznesit inxhinierik dhe konsulencë teknike.

Grupi Alfi është kryesisht aktiv në investimet dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme, veçanërisht në fushën e shitjes me pakicë, pagesën e borxheve dhe investime të tjera alternative.

Grupi Alfi, shikuar në kuptimin më të gjerë, është i pranishëm dhe gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Në përbërjen e tij më të gjerë, grupi Alfi ka shoqëritë e varura mëposhtme të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

- PRO KOLEKT SHPKNJP Shkup, me seli në Hristo Tatarçev 121-G, Kisella Vodë, Shkup, shoqëri e specializuar për mbledhjen jashtëgjyqësore të kërkesave. Aktiviteti kryesor i PRO KOLEKT SHPK Shkup është mbledhja dhe shlyerja e kërkesave. Këto aktivitete bazohen në kontrollin e debitorit dhe në ndërmarrjen e aktiviteteve afariste që janë të përshtatshme për sa i përket gjendjes së tyre ekzistuese pronësore dhe aftësive të pagesës;
- Apollo MK SHPKNJP Shkup, me seli në adresën bul. Kiro Gligorov nr. 13, Gazi Babë, Shkup, aktiv në tregtimin me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, magazina për fëmijë dhe produkteve tekstile për fëmijë.

IVIKOM Holding GmbH është shoqëria holding e Grupit Ivikom e cila kryesisht merret me konsulencë, ndërtim dhe menaxhim të elektraneve me erë ("Grupi Ivikom "). IVIKOM Holding GmbH u themelua në vitin 2021, pas ndarjes (spin-off-it) nga shoqëria Ivikom Konsalting (Ivicom Consulting), i cili u themelua në Republikën e Austrisë në 1991.

Përveç aktiviteteve të përmendura, IVIKOM Holding GmbH merret me hulumtimin e potencialit të erës dhe zhvillimin e projekteve për elektrane me erë.

Grupi Ivicom nuk është i pranishëm dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

shoqëria **VE Rakova Bara d.o.o. ZHagubica** u themelua në maj të vitit 2021 në Serbi me qëllim të zhvillimit dhe ndërtimit të parkut me erë "VE Rakova Bara" në komunën e Kuçevës (Serbi), me një kapacitet të instaluar të vlerësuar prej 140 MW. VE Rakova Bara d.o.o. Zhagubica posedon disa pasuri të paluajtshme, leje dhe të drejta për ndërtimin e parkut me erë.

VE Rakova Bara d.o.o. Zhagubica nuk është aktive, nuk ka shoqëri të varura të regjistruara dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски